



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

Nr. Prot. 257 Dt. 28.03.2022

**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI", MITROVICË  
Fakulteti i Inxhinierise Mekanike dhe Kompjuterike**

**RAPORTI PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2021**

Mitrovicë, Mars 2022

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; [info@umib.net](mailto:info@umib.net); Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË  
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

---

Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në mbledhjen e mbajtur më 21.02.2022, ka marrë vendim nr. Prot. 244, dt. 22.03.2022, për emërimin e komisionit për monitorimin e Planit Strategjik.

Komisioni i emëruar në këtë përbërje;

1. Prof. Asc. Dr. Faton Merovci
2. Prof. Ass. Dr. Fisnik Osmani
3. Prof. Ass. Dr. Faruk Ahmeti
4. MSc. Ass. Besmir Sejdiu
5. Blerina Beka, studente
6. Albina Halili, studente

**PËRGATITI**

**RAPORT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2019-2021**



## UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

---

### 1. Hyrje

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, është njësi akademike e UIBM, funksionon me programe unike, në dy nivele të studimeve BSc dhe MSc.

Këto programe studimore kanë një jetëgjatësi nga viti 1961. Fillimisht me Makineri Prodhuese dhe Energjetikë. Mitrovica ishte qytet industrial dhe kishte një traditë për industri të zhvilluar me profile inxhinierike që kanë ndiku në ekonominë e Kosovës.

FIMK - ku nga themelimi e deri në ditët e sotme ka luajtur një rol të rëndësishëm në arsimimin e lartë dhe përgatitjen e kuadrove të reja, fillimisht ka përgaditur kuadra profesionale për nevojat e Kombinatit "Trepça" por edhe më gjerë, varësisht nga kërkesat e industrisë dhe zhvillimit të vendit. Pra FIMK - ku është zhvilluar krahas zhvillimit të teknologjisë aktuale dhe ka ndrushuar edhe programet sipas kohës dhe nivelit teknologjik. FIMK, aktivitetet e veta mësimore i ka zhvilluar jashtë objekteve nga viti 1992 gjerë në vitin 2018 ku procesin mësimor tani e zhvillon në objektin e ri, me një hapësirë prej 12.000 m<sup>2</sup>.

### **HISTORIKU DHE PROFILI I FAKULTETIT TË INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

Që nga viti 1961, FIMK si institucion i lartë Universitar në Mitrovicë ka përgatitë ekspertë kompetentë, për kryerjen e punëve profesionale dhe shkencore në fushën e Makinerisë prodhuese, Shkencat Kompjuterike në Inxhinieri dhe Inxhinierisë ekonomike. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë sot kërkon edhe ndryshim të programeve të reja që të përshtatën profesioneve që i kërkon tregu i punës. FIMK edhe pse një kohë të gjatë aktivitetet e veta i ka krye jashtë lokaleve në vazhdimësi ka bërë ndryshimet e programeve për tri departamentet Makineri prodhuese, Shkencat Kompjuterike në Inxhinieri dhe inxhinieri ekonomike.

Objektet e reja të kampusit universitar të ndërtuara sipas standardeve evropiane ofrojnë mundësi të reja për organizimin e gjerë të punës mësimore dhe hulumtuese shkencore. FIMK ka hapësirë 12.000 m<sup>2</sup> me 40% laboratore të pajisur për nivelet; Bachelor dhe Master.



**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË  
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

---

**PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NË FIMK:**

Studimet e nivelit BSc të cilat në afate të rregullta janë nënshtruar procesit të akreditimit:

1. Makineri prodhuese
2. Shkencat Kompjuterike në Inxhinieri dhe
3. Inxhinieri ekonomike

Programet e lartëcekura në akreditimin e fundit janë akredituar për periudhën 2021-2024.

Studimet e nivelit MSc. për here të parë janë akredituar në vitin 2008:

1. Makineri prodhuese me dy profile dhe atë:
  - 1.1. Profili i prerjes dhe
  - 1.2. Profili i deformimit
2. Informatikë Inxhinierike është akredituar në vitin 2012 dhe
3. Inxhinieri ekonomike është akredituar në vitin 2019

Gjatë vitit akademik 2021/2022 programi i vetëm i akredituar në Master në FIMK është Inxhinieria Ekonomike.

Raporti për monitorimin e planit strategjik është për vitin 2021.

Informacionet, gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti, do na ndihmojnë në planifikimet e ardhshme.

Raporti do të kontribuojë në politikat arsimore, procesin e buxhetimit afatmesëm i cili është kyç në përcaktimin e drejtimit strategjik dhe alokimin e resurseve.

Plani Strategjik ka shërbyer si dokument kryesor planifikues, por edhe si një dokument me anë të cilit duhet të vlerësohet performanca e institucionit.

Për shkak të pandemisë COVID-19, kemi patur ngecje në disa fusha në kuadër të planifikimit strategjik e që këto do të adresohen në Planin e ardhshëm Strategjik. Disa nga aktivitetet me pjesëmarrje fizike nuk janë zhvilluar për shkak të pandemisë COVID-19- aty ku ka patur mundësi ato aktivitete janë zhvilluar online.



## UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

---

### 2. Metodologjia

Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti është bazuar në raportet e ndryshme që lidhen me planin strategjik dhe raportin e punës për vitin 2021 si dhe të dhënat e mbledhura nga vlerësimi i aktiviteteve të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2021.

### 3. Përmbledhje ekzekutive për progresin e arritur për objektivat

Bazuar në dokumentet e ofruara nga menaxhmenti i FIMK-ut dhe aktivitetet e ndërmarra, FIMK ka zhvilluar aktivitete mjaft të rëndësishme të cilat kanë rol të veçantë në realizimin e misionit dhe vizionit të FIMK-ut.

FIMK-u gjatë vitit 2021 ka arritur rezultate të dukshme në shumë fusha ku vlen të theksohet riakreditimi i 3 programeve në studimet bachelor për periudhën 3 vjeçare, dhe a përgaditur programet e nivelit MSc.

MSc në Makineri prodhuese

MSc. Në Shkenca kompjuterike me Inxhinieri dhe

MSc. Në Inxhiniri ekonomike

Për shkak të mosshpalljes së konkursit me kohë nga ana e Rektorit, nuk kemi pasur staf të mjaftueshëm për t'iu nënshtruar procesit të akreditimit, e kjo nuk ka ndodhur vetëm këtë vitë por vazhdimisht nga marrja e detyrës së Rektorit.

Raporti i monitorimit i PSFIMK ka për qëllim prezantimin e informatave dhe treguesve në implementimin e saj për vitin 2021.

Objektivat kryesore strategjike të parapara kanë për qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie, rritjen e programeve sidomos ato të masterit, rritjen e numrit të publikimeve dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore, rritjen e bashkëpunimit me palët e interesit dhe partnerët ndërkombëtarë me theks të veçantë rritjen e pjesëmarrjes në projektet Erasmus+.



## UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

---

Objektivat kryesore janë të pasqyruara si në vijim;

- 1. Mësimdhënie dhe zhvillim profesional**
- 2. Hulumtimi Shkencor**
- 3. Promovimi i FIMK-së, Misioni dhe rëndësia e tij në vend**
- 4. Ndërtimi i sistemit të sigurimit të cilësisë**

Disa nga vlerësimet e përgjithshme të arriturave në zbatimin e kësaj strategjie janë:

- ✓ Përfundimi me sukses i procesit të riakreditimit për studimet bazëBSc. në FIMK;
- ✓ Regjistrimi i 260 studentëve në studimet bachelor (programet Shkenca Kompjuterike me Inxhinieri, Makineri Prodhuese dhe Inxhinieri Ekonomike) dhe 30 studentë në Master të Inxhinierise Ekonomike.
- ✓ Rekrutimi i stafit të ri akademik (një profesor i rregullt) dhe avancimi i stafit aktual ne thirrje akademike.
- ✓ Organizimi i trajnimeve bazike në metodologjinë e re të mësimdhënies
- ✓ Bashkëpunimi me komunitet
- ✓ Realizimi i vizitave studimore të stafit të FIMK- ut për mobilitetit të përkrahur nga projektet ndërkombëtare-
- ✓ Rritja e numrit te publikimeve shkencore (10 publikime të stafit të FIMK-ut gjatë vitit 2021, të indeksuara në Scopus).
- ✓ Vazhdimi i projektit ITEM i përkrahur nga Erasmus+, që ka për qëllim zbatimin e metodave inovative të mësimdhënies së Matematikës në Shkenca Kompjuterike.
- ✓ Pjesëmarrja në Konferenca vjetore
- ✓ Organizimi i punëtorive UI and Coding në kuadër te klubit te kodimit
- ✓ Pjesëmarrja e studenteve te FIMK-ut ne garën për siguri kibernetike ku studentet tanë kanë zënë vendin e parë në garën "Kosovo Cyber Challenge" të organizuar nga UNDP-ja në bashkëpunim me Women4Cyber Albania, Telelink Business Services dhe IPKO Foundation.
- ✓ Pjesëmarrja e studenteve te FIMK-ut në garën Hackathon ku studentet tanë prap kanë zënë vendin e parë në këtë garë.



**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË**  
**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

**4. Objektiva Strategjike 1: Mësimdhënie dhe zhvillim profesional**

*Objektiva strategjike: 1. Ngritja akademike nëpërmjet programeve bashkëkohore*

Për të arritur objektiven e parë strategjike, ishin dizajnuar këto Objektiva Specifike:

<b>1.1.1 Trajnim për metodologjitë e reja të mësimdhënies</b>	
Statusi	Pjesërisht e realizuar
Arsyetimi	Deri në fund të 2021, trajnimin bazik për metodologjitë e reja të mësimdhënies e kanë ndjekur 48 përqind ku dhe janë certifikuar nga UP, 19 përqind e stafit e kanë ndjekur trajnimin me mungesa të theksuara që ka rezultuar me mos certifikim, ndërsa 33 përqind e stafit nuk e kanë ndjekur trajnimin (ku nga kjo përqindje, 10 përqind e tyre do pensionohet gjatë këtij viti akademik).

<b>1.1.2 Trajnim i avancuar për metodologjitë e mësimdhënies</b>	
Statusi	Pjesërisht e realizuar
Arsyetimi	Meqë kriter për ndjekjen e këtij trajnimi është që fillimisht të ndjekë trajnimi bazik (shih 1.1.1) atëherë edhe ky nën objektiv ka mbetur i parealizuar 100 përqind. Është ndjekur vetëm 14 përqind e stafit të FIMK-ut.

<b>1.1.3 Përshtatja e syllabuseve me zhvillimet në domenin specifik</b>	
Statusi	Plotësisht e realizuar
Arsyetimi	Gjatë vitit akademik 2021, FIMK iu ka nënshtruar akreditimit të programeve në nivelin BSc; Makineri Prodhuese, Shkenca Kompjuterike me Inxhinieri dhe Inxhinieri Ekonomike. Si kërkesë e akreditimit është kërkuar që të jetë përshtatja e syllabuseve me zhvillimet në domenin specifik, si dhe pas marrjes së draft raportit të gjitha vërejtjet rreth syllabuseve është dashtë të adresohen para se të jepet vendimi finalë i ekipit të ekspertëve. Meqë janë plotësuar të gjitha sygjërimet rreth syllabuseve e që kjo është pasqyruar me marrjen e akreditimit, konsiderojmë se ky nën objektiv është realizuar plotësisht.



**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË  
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

**Objektiva specifike: 1.2. Zhvillimi i një kurrikule moderne me theks në fushat e zhvillimit strategjik.**

<b>1.2.1. Ri-shikimi i planeve mësimore dhe programeve të aplikueshme</b>	
Statusi	Plotësisht e realizuar
Arsyetimi	Gjatë vitit akademik 2021, FIMK iu nënshtruar akreditimit të programeve: Makineri Prodhuese, Shkenca Kompjuterike me Inxhinieri dhe Inxhinieri Ekonomike. në kuadër të rishikimit të planeve mësimore, janë rishikuar planet ku është ndryshim sustancial në të gjitha programet e nivelit BSc, vlen të theksohet se: P.sh. në akreditimin paraprak kemi pas kurrikulen Informatikë Inxhinierike, tani kemi Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri.

**Objektiva specifike: 1.3. Rritja e aktivitetit akademik**

<b>1.3.1. Analizimi i rezultateve nga pyetësorët me stafin akademik;</b>	
Statusi	Plotësisht e realizuar
Arsyetimi	Koordinatori për sigurimin e Cilësisë në bashkëpunim me Zyrën për sigurimin e Cilësisë i kanë analizuar këta pyetësor dhe janë nxjerrë rekomandimet rreth kërkesave specifike të stafit akademik. Raportet janë të qasshme në webfaqen e UIBM.

<b>1.3.2. Analizimi i rezultateve nga pyetësorët për matjen e cilësisë me studentët: Një në përfundim të çdo semestri</b>	
Statusi	Plotësisht e realizuar
Arsyetimi	Koordinatori për sigurimin e Cilësisë në bashkëpunim me Zyrën për sigurimin e Cilësisë i kanë analizuar këta pyetësor dhe janë nxjerrë rekomandimet. Stafi akademik ka patur mundësi ti shoh të gjitha rezultatet për lëndët që i mbulojnë në sistemin SMU.

<b>1.3.3. Analizimi i rezultateve nga pyetësorët për matjen e cilësisë me menaxhmentin e UMIB-it</b>	
Statusi	Plotësisht e realizuar
Arsyetimi	Koordinatori për sigurimin e Cilësisë në bashkëpunim me Zyrën për sigurimin e Cilësisë i kanë analizuar këta pyetësor dhe janë nxjerrë rekomandimet.





**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË**  
**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

**Objektiva specifike: 1.4. Përmirësimi i studimeve nëpërmjet përdorimit të laboratorëve bashkëkohorë dhe pajisjeve në terren.**

<b>1.4.1. Sigurimi dhe mirëmbajtja e laboratorëve bashkëkohorë dhe pajisjeve të punës në terren,</b>	
Statusi	Plotësisht e realizuar
Arsyetimi	FIMK tani i ka dy laborante që merren me mirëmbajtjen e vazhdueshme të laboratorëve dhe në mënyrë të vazhdueshme në varësi të mjeteve të alokuara për FIMK është duke u pasuruar laboratorët e FIMK-ut dhe pajisjeve të ndryshme që shfrytëzohen nga studentët dhe stafi akademik për hulumtime shkencore.

<b>1.4.2 Lehtësimi i qasjes së studentëve në laboratorë dhe aktivitete në terren</b>	
Statusi	Plotësisht e realizuar
Arsyetimi	Te gjitha lëndët që kanë pjesën laboratorike, tanimë janë duke u mbajtur në laborator ku një punë të rëndësishme janë duke e kryer edhe laborantët së bashku me asistent e lëndeve që kanë pjesën laboratorike. Përveç mbajtjes së këtyre lendeve në laborator, tani me FIMK përmes rrjeteve sociale si facebook dhe webfaqja e UMIB here pas here i poston pjesën praktike të studenteve në laboratorët e FIMK-ut.

**Objektiva specifike: 1.5. Zhvillimi i programeve të reja master dhe programet e doktoraturës**

<b>1.5.1 Analizimi dhe vlerësimi i nevojave në vend për programe të reja</b>	
Statusi	Plotësisht e realizuar
Arsyetimi	Menaxhmenti i FIMK-ut së bashku me stafin akademik të FIMK-ut dhe në konsultim me bizneset kanë analizuar nevojën për programet e reja, me çka FIMK ka aplikuar për masterin në Makineri prodhuese dhe nuk ka aplikuar për Inxhinieri Ekonomike. Meqë tek bartësit për këtë program FIMK ka aplikuar me një dr shkencë të Makinerisë dhe një dr. shkencë të Fizikës (edhe pse Fizika është bazë e Makinerisë), nga agjencioni i Akreditimit është refuzuar kjo kërkesë për këtë program. KSHC e ka refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin se bartësi që mbanë thirrjen dr. i fizikës nuk konsiderohet adekuat në fushën e Makinerisë.



**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË**  
**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

<b>1.5.2 Aktivitete për hartimin e Rregullores për studime të doktoraturës</b>	
Statusi	I parealizuar
Arsyetimi	KSHC ka vendosur që për aplikimin në studimet e doktoratës të jene 5 bartës të fushës me se paku nga 3 punime shkencor në 3 vitet e fundit të indeksuara në Scopus ose Web of Science. Meqë FIMK është larg plotësimit të këtij kriteri, ku momentalisht nuk kemi staf që mund të jene bartës as në studimet e Masterit, andaj menaxhmenti i FIMK-ut ka vendosur që rregulloren për studime të doktoratës të shtyjë dhe mos ta hartoj deri sa të plotësohen kushtet për aplikimin në studime të doktoratës. Poshtu menaxhmenti është informuar se AKA se bashku me KSHC janë duke rishikuar standardet për akreditim të programeve, andaj në momentin që plotësohen kriteret për aplikim dhe ndryshon manuali për akreditim, FIMK do hartoj rregulloren e doktoratës. Për me tepër një rregullore e tillë mungon edhe në nivel institucional.

**Objektiva strategjike: 2. Hulumtimi Shkencor**

**2.1. Hartimi i planit strategjik të kërkimeve shkencore**

<b>2.1.1. Formimi i grupit punues dhe hartimi i planit strategjik të kërkimeve shkencore në FIMK</b>	
Statusi	I parealizuar
Arsyetimi	Meqë ka patur vonesë në aprovimin final të planit strategjik të kërkimeve shkencore në nivel institucional, ky objektivi është shtyrë për vitin 2022, meqë plani strategjik për hulumtime shkencore në kuadër të FIMK-ut duhet të jetë në harmoni me atë të UMIB. Ndryshe, FIMK ka marr pjesë me angazhimin e stafit të tij në hartimin e planit strategjik për hulumtime për UMIB.

<b>2.1.2. Hartimi i Rregullores dhe funksionalizimi i institutit në FIMK</b>	
Statusi	I parealizuar
Arsyetimi	FIMK gjatë vitit 2021 nuk ka arritur të funksionalizoj institutin në FIMK, rezultat, mungesa e stafit akademik dhe personelit ndihmës.



**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË  
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

**2.2. Krijimi i fondit nga të hyrat financiare për përkrahje të hulumtimit**

**2.2.1. Aplikimi për përkrahje nga skemat e ndryshme të MASHTI-t dhe partneritet në projekte të përbashkëta ndërkombëtare**

Statusi	I realizuar
Arsyetimi	FIMK gjatë vitit 2021 ka vazhduar të ketë përkrahjen nga projekti ITEM i financuar nga Erasmus+ si dhe disa projekte rreth sigurisë kibernetike. Poashtu në kuadër të disa projekteve që nuk janë në FIMK por që FIMK përfiton siç është projekti Research Cult ku stafi ka qasje në programin antiplagjiat, EBSCO dhe mobilitet, ku gjatë vitit 2021 një profesor nga FIMK ka qëndruar nëltali për 5 ditë në kuadër të vizitës studimore.

**2.3. Organizimi i konferencës së FIMK**

**2.3.1. Organizimi i edicionit vjetor të Konferencës multidisiplinare dhe ndërkombëtare në Gjeoshkenca**

Statusi	I realizuar
Arsyetimi	FIMK ka përkrahur konferencën vjetore të Gjeoshkencës dhe stafi i FIMKut deri tani nuk ka qenë aktiv në këtë konferencë me punime shkencore por pritet gjatë vitit 2022 të marrin pjesë edhe me punime shkencore. Kjo ka ndikuar sidomos me rregulloren për avancime ku preferohet që dy konferenca të jenë në UMIB për stafin që pritet të avancohet në thirrjen profesor i rregullt.

**Objektiva strategjike: 3. Promovimi i FIMK-së, Misioni dhe rëndësia e tij në vend**

**Objektiva specifike: 3.1. Përfshirja e FIMK-së në hulumtime dhe ngjarje me rëndësi të drejtpërdrejtë për shoqërinë**

**3.1.1. Organizimi i eventeve të përbashkëta lidhur me ngjarjet në FIMK, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit mes Alumnit, Bordit Industrial dhe përfaqësuesve të industrisë**

Statusi	I realizuar
Arsyetimi	Gjatë vitit 2021, FIMK ka marr pjesë me evente rreth akreditimit ku kanë qenë pjesë e këtij eventi Alumni, Bordi Industrial dhe përfaqësuesit e industrisë e që kjo pasqyrohet edhe në raportin e ekipit të ekspertëve për akreditimin e programeve 2021-2024.



**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË  
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

**3.1.2 Përfshirja e studentëve në projekte dhe teza masteri me lidhje të drejtpërdrejtë me industrinë lokale dhe çështje të komunitetit**

Statusi	I realizuar
Arsyetimi	Shumica e temave të diplomës të nivelit bachelor, janë duke u dhënë në lidhje të drejtpërdrejt me industrinë e kjo pasqyrohet me temat aplikative sidomos në Makineri prodhuese dhe Inxhinieri Ekonomike ku pothuajse secila temë ka si rast studimi një firmë lokale.

**3.1.3 Krijimi i ALUMNIT në kuadër të FIMK**

Statusi	I realizuar
Arsyetimi	Krijimi i Alumnit jo vetëm që është në kuadër të FIMK por është edhe në kuadër të UIBM dhe në kuadër të këtij anëtarësimi kemi edhe studentet e FIMK-ut.

**Objektiva strategjike: 3.2. Provomimi i FIMK-së**

**3.2.1. Hartimi i broshurave për studentë me informatat më relevante që kanë të bëjnë me Fakultetin dhe programet e studimit.**

Statusi	I realizuar
Arsyetimi	UIBM ka hartuar nje broshur për të gjitha programet e UIBM ku aty gjenden edhe informatat rreth programeve të FIMK-ut.

**3.2.2 Kampanjë informuese për maturantët**

Statusi	I realizuar
Arsyetimi	UIBM përmes zyrtarit për zhvillim të karrierës ka organizuar takime me maturantë ku u ka ofruar informata rreth programeve të ndryshme qe ofron UIBM e ndër to edhe FIMK.

**Objektiva specifike: 3.3. Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar i FIMK-së**

**3.3.1. Anëtarësim në shoqata të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare**

Statusi	I parealizuar
Arsyetimi	FIMK gjatë vitit 2021 nuk ka arritur të anëtarësohet në ndonjë shoqatë rajonale apo ndërkombëtare.



**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË  
FAKULTETI I INZHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

<b>3.3.2. Përkrahja e stafit për pjesëmarrje në Konferenca shkencore</b>	
Statusi	Pjesërisht i realizuar
Arsyetimi	UIBM ka përkrahur çdo kërkesë për pjesëmarrje në Konferenca shkencore dhe FIMK nuk ka ndonjë kërkesë që nuk është aprovuar qoftë nga UIBM apo nga MASHTI, megjithatë numri i kërkesave ka qenë jo i kënaqshëm. Kemi raste ku stafi i FIMK nuk ka aplikuar për përkrahje por ka marr pjesë në Konferencë me mjete vetanake.

<b>3.3.4. Pjesëmarrja e personelit akademik/ administrativ dhe studentëve në ngritjen e kapaciteteve profesionale për aplikim për mobilitet ndërkombëtar</b>	
Statusi	Pjesërisht e realizuar
Arsyetimi	Zyra e Erasmus+ në Kosovë kanë dhënë një prezantim për studentët dhe mësimitdhënësit e UIBM, ku të pranishmit janë njoftuar për mundësitë që ofron ky program. Stafi i FIMK-ut ka marr pjesë në mobilitete ndërkombëtare por numri i tyre është shumë i vogël në krahasim me numrin e stafit. Ende nuk kemi ndonjë aplikim nga stafi administrativ në mobilitete ndërkombëtare.

<b>3.3.5. Përcaktimi i lëndëve dhe organizimi i mësimit për lëndët me vlerë 15 kredi që do të ligjërohen në gjuhën Angleze</b>	
Statusi	I përealizuar
Arsyetimi	FIMK ka marr iniciativ për organizimin e mësimit në gjuhën angleze, (në secilin semestër nga një lëndë), por është dashur të ndërpritet procesi mësimor, sepse nuk ka pasur përkrahje nga rektori, dhe nuk ka arritur të zbatoj këtë objektivë specifike.

**Objektiva strategjike: 4. Ndërtimi i sistemit të sigurimit të cilësisë**



**UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË**  
**FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE**

<b>4.1.1 Implementimi i Udhëzuesit për sigurim të cilësisë në punën e FIMK</b>	
Statusi	I realizuar
Arsyetimi	UIBM përmes Zyrës për sigurimin e cilësisë i ka ndihmuar FIMK që të implementoj udhëzuesin për sigurimin e cilësisë ku raportet për cilësi rreth FIMK janë publikuar në webfaqe nga zyra për sigurimin e cilësisë për të gjitha fakultetet. (shih linkun: <a href="https://www.umib.net/wp-content/uploads/2022/03/Raporti-i-pyetesoreve-Bachelor-FIMK-Shkurt-2022.pdf">https://www.umib.net/wp-content/uploads/2022/03/Raporti-i-pyetesoreve-Bachelor-FIMK-Shkurt-2022.pdf</a> ) FIMK ka koordinatorin e cilësisë i cili në bashkëpunim me koordinatorin qendror për sigurimin e cilësisë janë kujdesur që ky objektiv specifik të zbatohet në FIMK.

**MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI**

Monitorimi dhe vlerësimi i Planit Strategjik, është faktori kryesor për zbatimin e strategjisë së mirëfilltë, për matjen e progresit të arritur. FIMK në bazë të vendimit të Këshillit, në mbledhjen e mbajtur me 22/03/2022, ka emëruar Komisionin për Monitorimin dhe Zbatimin e Planit Strategjik, detyrat e të cilit janë:

- Hartimi i planeve për të arriturat dhe veprimet që duhet ndërmarr në përputhje me PSFIMK;
- Analiza e progresit në zbatimin e PSFIMK, në bazë të informatave të mbledhura;
- Hartimi i buxhetit vjetor për zbatimin e PSFIMK, në kuadër të kufijve buxhetorë të përcaktuar;
- Shqyrtimi dhe miratimi i masave plotësuese për të siguruar zbatimin e PSFIMK;
- Hartimi i kërkesave për mbështetje nga programet e donatorëve me qëllim të sigurimit të zbatimit të PSIMK.

Për monitorimin, vlerësimin dhe implementimin e planit strategjik, përgjegjës është KFIMK, dhe Koordinatorin e grupit për Koordinimin, Monitorimin dhe zbatimin e PS, i cili do të hartoj dhe përpilojë raportin e performancës, dhe do të raportojë tek KFIMK, të gjeturat do të shqyrtohen nga ana e KFIMK-ut.

Këta tregues e mundësojnë monitorimin e progresit, duke vënë në dukje nivelin e arritjes së objektivave dhe realizimin e aktiviteteve strategjike.



## UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

---

Realizimi i Plani Strategjik dhe plani i veprimit, me siguri ka edhe implikime financiare, varësisht prej fushës studimore.

Implementimin i këtij plani, e lehtëson zhvillimin e FIMK-ut, njohjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me hulumtime shkencore të publikuara në rajon e më gjerë.

PSFIMK do të ndihmojë në vazhdimin e mëtejshëm drejt ngritjes së cilësisë në mësimdhënie, dhe hapjen e programeve të reja studimore, në harmoni me nevojat e tregut kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

FIMK është njësi akademike e UIBM, për mision ka; angazhimin e stafit akademik në mësimdhënie dhe kërkime shkencore në lëmin e Makinerisë Prodhuese, Inxhinierisë Ekonomike dhe Shkencave Kompjuterike me Inxhinieri.

FIMK, ka për qëllim të krijojë ambient inovativ dhe stimulues me të cilin studentët mund të zhvillojnë idetë, punën praktike dhe hulumtuese në fushat përkatëse.

FIMK, gjatë vitit 2021 ka synuar realizimin e misionit të tij, në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë në fuqi dhe me objektivat e parashikuara.

Si objektiva kryesore, në kuadër të procesit të mësimdhënies, janë identifikuar;

- Pajisja e studentëve me njohuritë më bashkëkohore;
- Përfshirja aktive e studentëve në procesin e të mësuarit, nëpërmjet nxitjes së të menduarit kritik;
- Angazhimi i studentëve në problematikat aktuale;
- Afrimi i studentëve drejt kërkimit shkencor;

Politikat e hulumtimit shkencor edhe gjatë vitit 2021, kanë synuar të arrijnë këto objektiva:

- Të rrisin performancën shkencore të personelit akademik me dimensionet bashkëkohore dhe nivelin kërkimor evropian;
- Të gjenerojnë kërkim shkencor, nëpërmjet: organizimit apo pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të personelit akademik; bashkëpunimit me profesorë vendas dhe të huaj; bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë për trajnimin dhe kualifikimin e stafit akademik;
- Të kthejnë FIMK dhe Universitetin në qendër të vlerave elitare dhe konkurruese;

Gjatë vitit 2021, është punuar me seriozitet për realizimin e objektivave, rekomandimeve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, si edhe për garantimin e standardeve të cilësisë nëpërmjet:

- Programeve dhe metodave të mësimdhënies bashkëkohore;
- Stafit akademik cilësor, me tituj dhe grada shkencore si dhe me eksperiencë punë;



## UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

---

- Ofrimit të shkollimit për një numër të arsyeshëm studentësh, komfor kapaciteteve që fakulteti disponon;
- Sigurimit të ambienteve dhe logjistikës së përshtatshme për realizimin e çdo aktiviteti mësimor, kërkimor dhe shkencor.

Gjatë vitit 2021, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike përmbushi synimet e planifikuara në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

### PROCESI I AKREDITIMIT

Programet e akredituara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim të cilat funksionojnë në kuadër të FIMK janë;

- Makineri Prodhuese BSc,
- Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri BSc,
- Inxhinieri Ekonomike BSc,
- Inxhinieri Ekonomike MSc,

Gjatë kësaj periudhe, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike ka zhvilluar një bashkëpunim dhe komunikim korrekt me Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Po ashtu kemi arritur që brenda afateve të përcaktuara t'i përmbushim obligimet për procesin e ri/akreditimit. Vlen të theksohet se gjatë procesit të punës për ri/akreditim janë bërë ndërhyrje të nevojshme dhe tejet domethënëse në plan-programet e reja, duke inkorporuar lëndë me interes për studentët dhe nevojat e tregut. Në vazhdimësi janë duke u përmbushur rekomandimet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

### PROCESI I MBARËVAJTJES SË MËSIMIT

Procesi i mbarëvajtjes së mësimin është zhvilluar me vështirësi të shumta, si pasojë e marrjes së masave kufizuese nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Gjatë këtij viti, procesi mësimor kryesisht është mbajtur me prezencë fizike. Po ashtu mirëmbajtja për pajisjet kompjuterike janë përcjellë me probleme dhe një pjesë e tyre janë jashtë funksionit. Me gjithë vështirësitë, Laboratori i FIMK-ut është funksionalizuar dhe ka qenë në shërbim të nevojave të studentëve.





## UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

---

Gjatë këtij viti, për fat të mirë është rekrutuar stafi profesional, përkatësisht janë punësuar dy laborantë.

Një ndër të arriturat e këtij viti mund të veçohet edhe vendosja e FIMK në objektin e ri të kampusit universitar, përkatësisht në objektin i cili është ndërtuar dhe destinuar për njësinë tonë akademike.

### PEOCESI I REALIZIMIT TË PROVIMEVE NËPËR AFATE

FIMK, ka organizuar sipas dinamikës mbajtjen e provimeve, sipas kalendarit të miratuar dhe sipas afateve të përcaktuara me Statutin e UIBM-së dhe vendimet e Senatit. Ashtu sikurse vështirësitë me mbarëvajtjen e procesit mësimor edhe mbarëvajtja e provimeve është shoqëruar me probleme si pasojë e masave kufizuese të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19.

Edhe gjatë këtij viti, FIMK-u është ballafaquar me kërkesa dhe sfidën e transferimit të studentëve nga programet e tjera në programet e UIBM.

### PROCESI I REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE

Procesi i regjistrimit të studentëve në vitin akademik 2021/2022, është zhvilluar sipas dinamikës së paraparë dhe komfor vendimit të AKA, vendimit të KFIMK dhe vendimit të Senatit të UIBM-së.

Procesit i pranimit/regjistrimit të studentëve në vitin akademik 2021/2022, është zhvilluar në tri faza, sipas afateve për pranimin e studentëve. Këtë proces e kanë mbikëqyrë komisionet e themeluara nga Këshilli i Fakultetit

Në vitin e parë të studimeve, sipas konkursit dhe afateve janë regjistruar gjithsej 257 studentë, sipas programeve;

- Makineri Prodhuese, BSc, 26 studentë,
- Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 141 studentë,
- Inxhinieri Ekonomike, BSc, 60 studentë,
- Inxhinieri Ekonomike, MSc, 30 studentë,



## UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

### PROCESI I REKRUTIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

Procesi i rekrutimit të stafit akademik, është përcjellë me sfida dhe vështirësi të shumta. Këto sfida kryesisht kanë të bëjnë me mungesën e kuadrove, me ggradë shkencore PhD, sidomos në fushën e Makinerisë Prodhuese dhe Shkencave Kompjuterike me Inxhinieri. Po ashtu nuk janë realizuar të gjitha kërkesat e fakultetit drejtuar rektoratit për hapjen e konkurseve për vende të lira të punës për personel akademik dhe administrativ. Për ta vështirësuar edhe më shumë këtë proces ka ndikuar hapja me vonesë e konkursit për staf akademik. Ky veprim ka shkaktuar vështirësi tejet të mëdha për fillimin me kohë dhe me rregull të vitit akademik, pastaj ka ndikuar direkt në mënyrë negative në përmbushjen e kriterëve për akreditimin dhe ri/akreditimin e programeve mësimore, duke pamundësuar deklarinimin me kohë të stafit akademik në AKA. Si rezultat i kësaj, tri programe të nivelit master të propozuara nga departamentet, të aprovuara në Këshillin e Fakultetit dhe në Senatit e UIBM nuk janë akredituar si pasojë e mos hapjes me kohë të konkurseve për zgjedhjen e stafit akademik. Një veprim i tillë ka ndodhur edhe më parë, prandaj si pasojë e moshpalljes së konkurseve dhe anulimin e tyre pas përfundimit të të gjitha procedurave e cila bartë pas veti pasoja të paparapame si në procesin mësimor po ashtu edhe në at financiar, kjo rrjedh nga papërgjegjësia e Rektorit.

### KËSHILLI I FAKULTETIT

Gjatë vitit 2021, Këshilli i Fakultetit, ka mbajtur trembëdhjetë mbledhje, në të cilat janë marrë vendime nga fusha përkatëse, janë aprovuar kërkesa, propozime etj. Këshilli i Fakultetit ka zhvilluar punën normalisht.

Edhe gjatë vitit 2021, FIMK ka mbajtur kontakte dhe korrespondencë korrekte me MASHT, AKA, në respekt të detyrimeve që burojnë nga ligji për Arsimin e Lartë.

### PJESËMARRJA DHE PROJEKTET E REALIZUARA

Gjatë vitit 2021, personeli akademik ka marr pjesë në 10 konferenca shkencore ndërkombëtare.

### KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ndër prioritet kryesorë për vitin 2022 FIMK, ka rekrutimin e stafit akademik, aplikimin për programe studimi MSc., rritjen e pjesëmarrjes të stafit akademik në konferenca shkencore, borde akademike të konferencave dhe revistave shkencore, rritjen e numrit të publikimeve shkencore të fushës, organizimin dhe pjesëmarrjen në punëtori dhe trajnime profesionale.



## UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE DHE KOMPJUTERIKE

Për akreditim dhe ri akreditim të programeve të studimeve themelore (bachelor), kërkohet të plotësohen kriteret sipas juridiksionit të Kosovës gjegjësisht udhëzimeve të AKA-së dhe standardeve ndërkombëtare.

Një ndër prioritetet tonë për vitet në vazhdim është zgjerimi me studimet master në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike por, që kjo e fundit të arrihet, sigurisht kërkohet rekrutim i stafit të rregullt akademik me gradën PhD dhe me specializime të fushës.

Gjithashtu, ndër prioritetet tona është edhe zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimit dhe angazhimi në projekte lokale dhe ndërkombëtare (hulumtime, shkëmbim të stafit akademik dhe studentëve, projekte të aplikueshme etj) me impakt pozitiv në zhvillimin e stafit akademik, studentëve dhe komunitetit.

Mbështetje për stafin akademik për zhvillim profesional dhe akademik përmes pjesëmarrjes në trajnime, konferenca, seminare, studime të avancuara, publikime etj.

Bazuar në rezultatet e arritura dhe sfidat që kishim gjatë vitit 2021, ne si njësi akademike përmes rekomandimeve propozojmë implementimin e politikave, programeve dhe projekteve të ndryshme, në interes të ngritjes së preformancës dhe cilësisë së punës dhe shërbimeve.

- Procedimi me kohë i kërkesave për zgjedhjen e stafit akademik dhe administrativ,
- Komunikim i vazhdueshëm sidomos me stafin akademik në marrëdhënie të rregullt pune, duke ju ofruar kushte të volitshme pune në mënyrë që të ketë stabilitet dhe mos largim të tyre nga marrëdhënia e punës me institucionin tonë,
- Ngritja e kapaciteteve profesionale në Laboratorët e fakultetit,
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit administrativ,
- Ngritja në nivel më të lartë e komunikimit institucional

Komisioni për monitorimin e planit strategjik

1. Prof. Asc. Dr. Faton Merovci
2. Prof. ASs. Dr. Fisnik Osmani
3. Prof. ASs. Dr. Faruk Ahmeti
4. MSc. Ass. Besmir Sejdiu
5. Blerina Beka, studente
6. Albina Halili, studente



Dekani, FIKM

Prof. dr. Hakif Zeqiri

Mitrovicë, 25/03/2022